

ÇFARË E PRET KOSOVËN

NDËRSA BE-ja NIS HEQJEN E MASAVE?

FAQE 4-5

Bashkimi Evropian ka njoftuar se në muajin janar do të nisë heqjen graduale të sanksioneve ndaj Kosovës. Ky hap mund t'i ringjallë shpresat evropiane të Kosovës, pasi 2026-ta mund të jetë viti kur aplikimi për anëtarësim në BE, i dorëzuar në fund të vitit 2022, do të shqyrtohet për herë të parë nga Komisioni Evropian

KËSHILLI SHQIPTARO-AMERIKAN MIRËPRET RIFILLIMIN E DIALOGUT STRATEGJIK, KËRKON HAPA KONKRETË NGA KOSOVA

F. 3



MIDIS MOSMARRËVESHJEVE DHE BASHKËPUNIMIT: RAPORTET E KOMUNAVE NË VERI DHE QEVERISË SË RE

F. 4

OPINION

LUMIR ABDIXHIKU E PASKE KALUAR VIJËN, RËNDË DHE PA KTHIM

F. 6

Shkruan:

Hisen BERISHA

AKTUALE

TRUMPI PO SHOYRTON “OPSIONE TË FORTA” KUNDËR IRANIT

F. 2

OKUK SHËNON REKORD NË VITIN 2025 ME MBI 400 OPERIME KARDIOKIRURGJIKE

F. 7

EKONOMI

EKONOMIA E KOSOVËS NË DEKADËN E FUNDIT: RRIJTJE NË SHIFRA, ULJE NË JETËN REALE

F. 8

MË SHUMË VIZITORË NË HOTELE NË NËNTOR 2025 KRAHASUAR ME NJË VIT MË PARË

F. 8

SPORT

OSMANI DEKORON ARATIN PËR KONTRIBUTIN NË KANDIDIMIN E KOSOVËS PËR ORGANIZIMIN E LOJËRAVE MESDHETARE

F. 10

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepcisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.PK.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

Buniamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

KB

KOLEGJI BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com

info@kolegji.biznesi.com

030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

TRUMPI PO SHQYRTON ‘OPSIONE TË FORTA’ KUNDËR IRANIT

UASHINGTON, 12 JANAR - Presidenti amerikan Donald Trump thotë se ShBA-ja po shqyrton “mundësi shumë të forta” për ndërhyrje në Iran për shkak të dhunës ndaj njerëzve që po protestojnë. “Ushtria po e shqyrton këtë”, tha Trumpi të dielën në mbrëmje. Trumpi dhe ekipi i tij i sigurisë kombëtare po shqyrtojnë mundësi duke përfshirë sulme kibernetike dhe sulme ushtarake nga ShBA-ja ose Izraeli, i thanë Associated Press dy persona të informuar mirë me zhvillimet në Shtëpinë e Bardhë. Të shtunën “udhëheqësit e Iranit” telefonuan. “Ata duan të negociojnë”, tha Trumpi. Ai fillimisht nuk dha hollësi rreth përbajtjes së bisedimeve apo nëse ato mund ta trajtonin edhe programin bërthamor të diskutueshëm të Iranit, por tha se një takim po organizohet. Në të njëjtën kohë ai theksoi: “Mund të na duhet të veprojmë para një takimi”. Presidenti amerikan njoftoi se do të flasë

me sipërmarrësin Elon Musk për rivendosjen e qasjes në internet në Iran. Kompania e Muskut, “SpaceX”, me shërbimin e saj “Starlink”, është ofruesja kryesore në botë e internetit satelitor. Regjimi iranian vendosi një ndërprerje të internetit javën e kaluar. Kryetari i Parlamentit iranian, Mohammed Bagher Kalibaf, ka kërcënuar më parë se ushtria amerikane dhe Izraeli mund të ishin objektiva legjitime për Iranin nëse Shtetet e Bashkuara do të ndërhynin ushtarakisht në Iran. Një sulm parandalues gjithashtu nuk përjashtohet.

Numri i të vdekurve në protesta rritet

Të dielën protestat vazhduan në të gjithë vendin. Sipas aktivistëve, ato janë përhapur në 185 qytete. Grupet e të drejtave të njeriut raportojnë vdekje të shumta, megjithëse numri i saktë është i paqartë. Rrjeti i të



drejtave të njeriut me bazë në ShBA, HRANA, raporton 483 demonstrues të vrarë. Deri më tani kanë vdekur gjithsej 544 persona, përfshirë fëmijë dhe 47 anëtarë të forcave të sigurisë. Rreth 10 700 persona janë arrestuar, shtoi rrjeti. Shifrat e HRANA-s nuk mund të verifikohen në mënyrë të pavarur. BBC citoi një burim në Teheran që thotë: “Situata këtu është shumë, shumë e keqe”. Forcat e sigurisë thuhet se po përdorin municione luftarake. “Është si një zonë lufte, rrugët janë të mbuluara me gjak. Ata po i transportojnë trupat me

kamionë”, tha burimi. As këto raportime nuk mund të verifikohen në mënyrë të pavarur.

Djali i Shahut bën thirrje për përshkallëzim të mëtejshëm

Reza Pahlavi, djali i Shahut të rrëzuar në vitin 1979, ka bërë thirrje për fazën tjetër të kryengritjes në një mesazh të ri për lëvizjen protestuese në Iran. Përveç pushtimit të rrugëve qendrore në qytete, të gjitha institucionet përgjegjëse për propagandën e qeverisë dhe ndërprerjen e komunikimit tani janë “objektiva legjitime”, deklaroi ai në platformën “X”. Pahlavi bëri thirrje që “flamuri i turpshëm i Republikës Islamike” të zëvendësohet në të gjitha ambasadat dhe konsullatat iraniane jashtë Iranit me flamurin e vjetër të përdorur për herë të fundit gjatë mbretërimit të babait të tij, Shahut

Mohammed Reza Pahlavi. Por për shkak të mbylljes së internetit, është e paqartë nëse dhe në çfarë mase njerëzit në Iran mund t’i shohin kërkesat e Pahlavit.

Guterres “i tronditur”

Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, António Guterres, ka shprehur tronditjen e tij nga raportet për dhunë kundër protestuesve në Iran. “E drejta e lirisë së shprehjes duhet të respektohet plotësisht”, shkroi ai në platformën “X”. Ai u bëri thirrje autoriteteve iraniane të mos përdorin dhunë kundër demonstruesve. Guterres gjithashtu bëri thirrje për rivendosjen e qasjes në informacion për popullin e Iranit. Protestat në Iran filluan dy javë më parë, të shkaktuara nga situata e rëndë ekonomike e vendit. Që atëherë ato janë përshkallëzuar në demonstrata masive kundër udhëheqjes në Teheran.

LIDHJET E GRUPEVE KRIMINALE NGA BALLKANI ME VENEZUELËN

HAGË, 12 JANAR - Grupet e organizuara kriminale nga Ballkani kanë lidhje edhe në Venezuelë. Këtë e tregojnë rastet e sekuestrimeve të kokainës, arrestimeve dhe procedurave gjyqësore që janë përfunduar ose që janë ende në zhvillim. Këto grupe janë identifikuar nga organizata ndërkombëtare si EUROPOL dhe INTERPOL. Venezuelja ka ardhur në qendër të vëmendjes ndërkombëtare si një shtet transit për trafikimin e kokainës pas arrestimit të udhëheqësit të rrëzuar Nicolas Maduro nga forcat e Shteteve të Bashkuara në fillim të janarit. Maduro do të përballlet me gjykim në ShBA në bazë të një aktakuze që e ngarkon për mbikëqyrje të një rrjeti të tregtisë me kokainë, që ka bashkëpunuar me grupe të dhunshme, përfshirë kartelet meksikane Sinaloa dhe Zetas, rebelët majtistë kolumbianë të FARC-ut dhe bandën venezuelase Tren de Aragua. Maduro në seancën e parë dëgjimore të mbajtur në një gjykatë në Nju-Jork i mohoi akuzat.

Cili është rëndësia e Venezuelës për grupet kriminale nga Ballkani?

Siç thekson për Radion Evropa e Lirë, Sasha Gjorgjeviq nga Nisma Globale për Luftimin e Organizatave Kriminale Transnacionale (GI-TOC), Venezuela është e rëndësishme për kontrabandën e kokainës, në të cilën janë të përfshira rrjete kriminale nga Ballkani. Perëndimor, sepse ajo përbën “korridor strategjik dalës nga

Amerika Latine drejt Atlantikut”. Nga atje, shumica e kokainës shkon ose direkt në Evropë, ose përmes Afrikës Perëndimore në Evropë. Sipas tij, për grupet kriminale nga Ballkani, Venezuela është e rëndësishme, por jo destinacioni kryesor për trafikimin e kokainës nga Amerika Latine drejt Evropës. Në këtë kuptim, vendet si Kolumbia dhe Brazili janë shumë më të rëndësishme, dhe në vitet e fundit edhe Ekuadori. Arrestimi i Maduros dhe veprimet e ShBA-së kundër grupeve kriminale që merren me trafikimin e kokainës, sipas Gjorgjeviqit, nuk do të kenë shumë ndikim të këto grupe, anëtarët e të cilave janë me origjinë nga vendet e Ballkanit. “Duke pasur parasysh se këto grupe gjithmonë kanë qenë fleksibile, supozoj se ato grupe që kanë përdorur Venezuelën do të gjejnë rrugë alternative në këto vende ku, sipas meje, ekzistojnë baza shumë më të rëndësishme”, vlerëson ai.

Kush janë aktorët kryesorë?

Lidhjet e grupeve kriminale nga Ballkani me Venezuelën u zbuluan përmes sekuestrimit të kokainës pranë bregut të Arubës, afër Venezuelës, në shkurt të vitit 2020. Në atë rast, marina holandeze ndaloi anijen “Aressa”, e cila më parë ishte ankoruar në portin venezuelas të Guaranos. Në bordin e anijes u sekuestruan 5 tonë kokainë. Gjatë aksionit u arrestuan 11 shtetas të Malit të Zi, pjesëtarë të

ekuipazhit të anijes. Sipas Drejtorisë së Policisë së Malit të Zi, sekuestrimi i kokainës në Arubë ishte si rezultat i bashkëpunimit mes Malit të Zi, Mbretërisë së Bashkuar, Serbisë dhe Holandës. Para gjykatës në Arubë, shtetasit malazezë u dënuan në mars të vitit 2021 me dënime nga nëntë deri në 15 vjet burgim. EUROPOL-i e lidhi kokainën e sekuestruar në Arubë me shtetasin serb Miroslav Starceviq, i arrestuar në maj të vitit 2023 së bashku me 12 persona të tjerë. Ata akuzohen nga autoritetet në Serbi për trafik ndërkombëtar të drogës. Siç është konfirmuar për Radion Evropa e Lirë nga Gjykata e Lartë në Beograd, procesi gjyqësor kundër këtij grupi është drejt fundit. Policia serbe e ka cilësuar Starceviqin si udhëheqës kryesor “i organizatës më të madhe kriminale për trafikim të drogës nga Ballkani” që u zbulua me ndihmën e EUROPOL-it. Sipas policisë serbe, karteli i udhëhequr nga Starceviq qëndron pas dërgesave me shumë tonë kokainë që kanë mbërritur në Evropë nga Kolumbia, Brazili, Ekuadori, por edhe përmes Afrikës Perëndimore. Grupi i Starceviqit në raportet e GI-TOC lidhet me klanin Kavaç, klan kriminal me origjinë nga Mali i Zi. Klanet Kavaç dhe Shkalar janë nga Mali i Zi. Bëhet fjalë për dy klane të armatosura, e gjatë përplasjeve që kanë pasur që nga viti 2014 kanë humbur jetën më shumë se 60 persona.

Pa përgjigje nga ministria e Brendshme e Serbisë dhe e Malit të Zi

Nuk dihet nëse dhe sa janë të përfshira ende grupet kriminale, pjesëtarë të të cilave janë me origjinë nga Serbia dhe Mali i Zi, në trafikun e kokainës të lidhur me Venezuelën. Për këto pyetje, deri në publikimin e këtij teksti, nuk janë përgjigjur Ministria e Brendshme e Serbisë, as ajo e Malit të Zi. Nga EUROPOL-i thanë shkurt për REL-in se organizata nuk ka bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Venezuelën, kështu që të dhënat për përfshirjen e grupeve kriminale nga Ballkani merren në mënyrë indirekte nga policitë e këtyre shteteve. Grupet kriminale nga vendet e Ballkanit Perëndimor, në raportet e agjencive ndërkombëtare si EUROPOL dhe INTERPOL, cilësohen të rëndësishme për trafikun e kokainës nga Amerika Latine, kryesisht drejt vendeve të Evropës Perëndimore. Këtë pozicion, sipas raporteve të GI-TOC, ato e kanë ndërtuar për dekada, kryesisht përmes lidhjeve të drejtpërdrejta me vendet prodhuese dhe distributorë të kokainës.

Pse është e veçantë Venezuela?

Ajo që e bën Venezuelën interesante, thotë Gjorgjeviq nga GI-TOC, është përdorimi i transportit detar dhe ajror për kokainën që dërgohet nga ky shtet. “Janë avionë të vegjël, për të cilët



kontrolli dhe monitorimi është shumë më i ulët se për fluturimet komerciale”, shpjegon ai. Në Venezuelë nuk prodhohet kokainë, por sipas raporteve të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), Venezuela cilësohet si një nga shtetet kryesore transit për kokainën, e cila prodhohet kryesisht në Kolumbi dhe më pas shpërndahet drejt ShBA-së dhe Evropës. Indikacionet e forta që pjesë të aparatit shtetëror venezuelas janë të përfshirë në aktivitetet kriminale vijnë nga gjetjet e Indeksit për Krim Global, sipas të cilit, Venezuela renditet në dhjetë përqindëshin më të lartë të vendeve në botë për ndikimin e aktorëve kriminalë brenda vendit. Raportet vjetore për këtë indeks i publikon GI-TOC, organizatë joqeveritare me seli në Gjenevë. Në raportin e fundit të publikuar në nëntor të vitit 2025 thuhet se grupet guerile kolumbiane “menaxhojnë zinxhirët e furnizimit në bashkëpunim me zyrtarë të korruptuar venezuelas”. “Grupet janë integruar në komunitetet lokale, shpesh duke manipuluar të rinjtë që të punojnë për ta nën maskën e punësimit të ligjshëm, dhe kanë marrë në dorë sistemet lokale të drejtësisë dhe strukturat e qeverisjes”, theksohet në raport.

KËSHILLI SHQIPTARO-AMERIKAN MIRËPRET RIFILLIMIN E DIALOGUT STRATEGJIK, KËRKON HAPA KONKRETË NGA KOSOVA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 JANAR - Këshilli i Marrëdhënieve Shqiptaro-Amerikane (AARC) ka mirëpritur deklaratat e Shteteve të Bashkuara për rifillimin e Dialogut Strategjik me Kosovën, ndonëse ende nuk ka rifilluar zyrtarisht. Përmes një letre, AARC shkruan se marrëdhëniet kanë pësuar sfida të konsiderueshme, përfshirë pezullimin e projekteve të rëndësishme si Millennium Challenge Corporation (MCC) dhe ndërprerjen e Dialogut Strategjik për shkak të veprimeve që ShBA i konsideroi “të njëanshme”.

“Rilidhja e dialogut formal do të sinjalizonte gatishmërinë e të dy palëve për të ecur përpara në mënyrë konstruktive dhe me koordinim më të madh”, ka shkruar AARC.

Organizata vlerëson se zgjedhjet e fundit në Kosovë tregojnë përkushtimin ndaj demokracisë, por edhe frustrimin publik ndaj presionit ndërkombëtar. “Zgjedhjet e fundit të Kosovës jo vetëm që riafirmojnë

përkushtimin e vendit ndaj proceseve demokratike, por gjithashtu pasqyrojnë rritjen e pakënaqësisë publike ndaj presionit ndërkombëtar - herë-herë të padrejtë - me të cilin Kosova është përballur gjatë kësaj periudhe. Kjo ndjenjë duhet marrë seriozisht nga Shtetet e Bashkuara ndërsa shqyrtojnë angazhimin më të gjerë strategjik me Kosovën. Zgjedhjet ofrojnë si një mandat ashtu edhe një mundësi për të konsoliduar institucionet që janë të afta të përcaktojnë një rrugë të re dhe të rivendosin marrëdhëniet me Uashingtonin mbi një bazë më të qëndrueshme. Ka një interes të qartë dhe të qëndrueshëm të përbashkët për një Kosovë të fortë, të qëndrueshme dhe sovranë. Në një kohë sfidash të rritura globale të sigurisë dhe presionesh destabilizuese nga Lindja, roli i Kosovës si një partner i besueshëm në Ballkanin Perëndimor mbetet strategjikisht i rëndësishëm. Kjo është demonstruar nga mbështetja e vazhdueshme ushtarake dhe e sigurisë nga ShBA, madje edhe gjatë periudhave të tensioneve diplomatike - duke reflektuar



një përkushtim afatgjatë që duhet të marrë një përgjigje serioze politike përkatëse”. Njëherësh, AARC theksoi rëndësinë e një përgjigjeje serioze nga Kosova, duke përfshirë një vizitë të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti në Uashington, për të treguar përkushtim ndaj rifillimit të marrëdhënieve strategjike. “Qëllimi i deklaruar nga Shtetet e Bashkuara për të rivendosur Dialogun Strategjik është një gjest i rëndësishëm. Kosova tani duhet të përgjigjet me një gjest të kuptimplotë të vetin - një që tregon pjekuri

strategjike dhe një përkushtim të sinqertë për rivendosjen e marrëdhënies. Thelbi i këtij përpjekjeje duhet të jetë siguri i një vizite të vonuar prej kohësh nga kryeministri Kurti në Uashington. Kosova duhet të ndërtojë mbi punën e rëndësishme dhe të qëndrueshme të kryer nga presidentja Osmani në ruajtjen dhe thellimin e lidhjeve me Uashingtonin, madje edhe gjatë momenteve të vështira. Kjo përpjekje tani duhet të forcohet në të gjithë qeverinë. Mbajtja dhe zgjerimi i angazhimit në të gjitha nivelet

do të jetë thelbësor për të siguruar që çdo Dialog Strategjik i ri të sjellë rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme. AARC është e gatshme të mbështesë këtë kapitull të ri dhe inkurajon fuqishëm Qeverinë e re të Kosovës që të shfrytëzojë këtë moment për të rivendosur dhe forcur plotësisht partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara - të bazuar në respekt të ndërsjellë, vlera demokratike dhe interesa strategjike të përbashkëta”, shkruhet në deklaratën e AARC-së.

KQZ-ja TEKNIKISHT E GATSHME PËR T’I SHPALLUR REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE, PRET PËRFUNDIMIN E ANKESAVE

PRISHTINË, 12 JANAR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është teknikisht i gatshëm për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, por ky hap do të ndërmerret vetëm pas përfundimit të plotë të procesit të ankesave. Kështu ka bërë me dije zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, në një deklaratë për “Telegrafi”-n. Sipas Elezit, KQZ-ja aktualisht është në pritje të përfundimit të shqyrtimit të ankesave që kanë të bëjnë me administrimin e numërimit në Qendrat e Numërimit të Rezultateve (QNR), si dhe të plotfuqishmërisë së vendimeve dhe zbatimit të tyre. “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është në pritje të përfundimit të shqyrtimit të ankesave për



administrimin e numërimit në QNR, të plotfuqishmërisë së vendimeve dhe të zbatimit të tyre, nëse këto vendime e detyrojnë ndonjë gjë KQZ-në. Vetëm pas kësaj, KQZ do të procedojë me shpalljen e

rezultatit përfundimtar”, ka deklaruar Elezi. Ai ka sqaruar se shpallja e rezultateve përfundimtare nuk nënkupton përfundimin e plotë të procesit zgjedhor, pasi ligji u jep të drejtë subjekteve politike

dhe kandidatëve që të parashtrinë ankesa edhe ndaj vetë rezultatit. “Subjektet politike dhe kandidatët kanë të drejtë ankesë ndaj rezultatit, fillimisht në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), e më pas çështja mund të procedohet deri në Gjykatën Supreme. KQZ është e obliguar të presë këto vendime, t’i zbatojë ato dhe vetëm pas kësaj të procedojë me certifikimin e rezultateve”, ka theksuar zëdhënësi i KQZ-së. Ndërkohë, Gjykata Supreme e Kosovës ka konfirmuar për “Telegrafi”-n se aktualisht nuk ka asnjë ankesë të paraqitur në këtë institucion lidhur me zgjedhjet. “Lidhur me kërkesën tuaj, bazuar në informacionet

nga Zyra për Menaxhimin e Lëndëve, aktualisht nuk ka ndonjë ankesë lidhur me Zgjedhjet, të paraqitur në Gjykatë Supreme”, ka deklaruar Antigona Uka-Lutfiu, udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media. Megjithatë, Uka-Lutfiu ka theksuar se nga Gjykata Supreme gjatë këtij viti është shqyrtuar një ankesë lidhur me zgjedhjet, e cila është refuzuar si e pabazuar. Ndërsa deri në fund të vitit 2025, Gjykata Supreme ka pranuar gjithsej tri ankesa: dy prej tyre janë refuzuar si të pabazuara, ndërsa një ankesë është hedhur poshtë si e paraqitur jashtë afatit ligjor.

Gjermania riafirmon mbështetjen për FSK-në

Prishtinë, 12 janar - Zëvendësambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Bottcher, ka takuar komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Rrahman Jashari, për të diskutuar mbi procesin e transformimit dhe të ardhmen e

institucionit. Sipas njoftimit të Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë, komandanti Jashari shprehu mirënjohje për mbështetjen e gjatë të Gjermanisë në zhvillimin e FSK-së. Ndërsa zëvendësambasadori

Botcher theksoi se Gjermania do të vazhdojë të qëndrojë pranë Kosovës dhe riafirmoi angazhimin e saj për t’i parë institucionet e sigurisë së Kosovës si pjesë të një arkitekture të përbashkët dhe të integruar të sigurisë evropiane.



ÇFARË E PRET KOSOVËN NDËRSA BE-ja NIS HEQJEN E MASAVE?

Bashkimi Evropian ka njoftuar se në muajin janar do të nisë heqjen graduale të sanksioneve ndaj Kosovës. Ky hap mund t'i ringjallë shpresat evropiane të Kosovës, pasi 2026-ta mund të jetë viti kur aplikimi për anëtarësim në BE, i dorëzuar në fund të vitit 2022, do të shqyrtohet për herë të parë nga Komisioni Evropian

PRISHTINË, 12 JANAR - Bashkimi Evropian ka njoftuar se në muajin janar do të nisë heqjen graduale të sanksioneve ndaj Kosovës. Sanksionet janë vendosur në verën e vitit 2023, pasi Prishtina zyrtare ka zbatuar rezultatet e zgjedhjeve të kontestuara në veriun e banuar me shumicë serbe pavarësisht prej paralajmërimeve nga Brukseli.

Ky hap mund t'i ringjallë shpresat evropiane të Kosovës, pasi 2026-ta mund të jetë viti kur aplikimi për anëtarësim në BE, i dorëzuar në fund të vitit 2022, do të shqyrtohet për herë të parë nga Komisioni Evropian. Po ashtu, ekziston mundësia që dialogu Kosovë - Serbi, i ndërmjetësuar nga Brukseli, të rifillojë pas një ndërprerjeje dyvjeçare.

Sanksionet kanë qenë të diskutueshme dhe pa precedent në raportet e BE-së me një vend aspirant për anëtarësim. Ato nuk kanë qenë sanksione në kuptimin e plotë politik dhe procedural, ndaj në qarqet e Brukselit janë konsideruar më tepër si "masa".

Sanksionet e BE-së duhet t'u paraqiten 27 shteteve anëtare përmes një akti formal ligjor dhe të miratohen njëzëri. Kjo ka ndodhur, për shembull, në vitin 2019, kur Brukseli ka ngrirë asetet dhe ka ndaluar vizat për individë nga Turqia - vend kandidat për anëtarësim në BE - për shkak të shpimeve të paautorizuara për gaz në Mesdheun Lindor.

Në rastin e Kosovës, një procedurë e tillë nuk është ndjekur. Në vend të saj, shefi i atëhershëm i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell, u ka dërguar një letër shteteve anëtare, ku i ka përshkruar masat dhe u ka rekomanduar kryeqyteteve që t'i zbatojnë ato, ndonëse nuk ka pasur ndonjë detyrim formal.

Drejtorja e Përgjithshme për Zgjerim - departament i BE-së që merret me vendet që synojnë anëtarësimin në bllok - e ka njoftuar më pas Kosovën për masat që do të ndërmerren kundër saj.

Këto masa kanë qenë kryesisht të natyrës së brendshme të BE-së; ato kanë përfshirë ngrirjen e fondeve për Kosovën nga buxheti i përbashkët i BE-së, pezullimin e vizitave të nivelit të lartë dhe mosmbajtjen e mbledhjeve të Këshillit të Stabilizim-Asociimit - mekanizmit kryesor politik të marrëdhënieve Bruksel-Prishtinë - deri në një njoftim të dytë.

Ndonëse për vendosjen e masave nuk ka pasur unanimitet formal të shteteve anëtare të BE-së, për heqjen e tyre është kërkuar.

Kur Borrell - në njërin nga veprimet e tij të fundit para largimit nga detyra në vitin 2024 - ka kërkuar heqjen e masave, nuk ka pasur konsensus dhe vendimi fillestar ka mbetur në fuqi.

Një dinamikë e re në favor të Kosovës është krijuar me nisjen e punës së përbërjes së re të Komisionit Evropian në fund të vitit 2024, kur disa diplomatë evropianë kanë vlerësuar se komisionari në largim për Zgjerimin, Oliver Varhelyi, i cili vinte nga Hungaria, ka pasur "një simpati të veçantë" për Serbinë dhe ka penguar çdo lëvizje reale në favor të Kosovës.

Më pas është paralajmëruar "heqja graduale" e masave, por nuk është shpjeguar qartë se cilat masa do të hiqeshin dhe në çfarë afati.

Gjatë vitit 2025, Kosovën e kanë vizituar presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, dhe shefja e diplomacisë së BE-së, Kaja Kallas, duke hedhur poshtë idenë se ekzistonte ndalesa për vizita të nivelit të lartë.

Megjithatë, gjatë vitit të kaluar, asnjë politikan i lartë kosovar nuk ka realizuar ndonjë vizitë dypalëshe në Bruksel.

Një përparim i madh politik ka ndodhur pastaj në Samitin BE-Ballkani Perëndimor, i cili është mbajtur në Bruksel, më 17 dhjetor. Atë ditë, von der Leyen ka njoftuar se masat ndaj Kosovës do të hiqen.

Ky vendim ka pasuar zgjedhjet lokale të tetorit në veri të Kosovës, të cilat



Brukseli i ka vlerësuar si "të qeta dhe paqësore", duke përmbysur kështu qasjen që ka ndërmarrë në vitin 2023.

Megjithatë, kjo nuk ka shënuar fundin e rrëfimit. Para samitit, Franca, Hungaria, Italia, Sllovakia dhe Spanja kanë propozuar që heqja e masave të bëhej në dy faza.

Sipas këtij plani, gjysma e parave të ngrira, rreth 216 milionë euro, do të lëshohet menjëherë për Prishtinën, ndërsa gjysma tjetër, 205 milionë euro, do të shpërndahej pas zgjedhjeve parlamentare më 28 dhjetor.

Arsyeja ishte se lëshimi i menjëhershëm i të gjitha parave, do t'i jepte avantazh të madh politik kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, gjatë fushatës zgjedhore.

Kushti i ri është vendosur nga pothuajse të njëjtat shtete që në vitin 2023 kanë luajtur rol kyç në shmangien e masave të ngjashme të BE-së ndaj Serbisë, pasi militantë serbë - me mbështetje të dyshuar nga Beogradi zyrtar - kanë sulmuar Policinë e Kosovës në fshatin Banjskë, duke lënë një oficer të vrarë.

Disa shtete të tjera anëtare të BE-së janë ankuar se vendet proserbe po nxisnin sërish veprime kundër Kosovës, por më pas kanë rënë dakord, duke dëshiruar të shmangnin një tjetër ngërç politik.

Në fund, Kurti ka rritur numrin e votave dhe BE-ja ka njoftuar menjëherë se gjysma e dytë e parave të ngrira do të lirohet në fillim të vitit 2026. Problemi tani është se, edhe pse janë marrë vendimet politike për heqjen e të gjitha masave, puna teknike nuk ka filluar ende.

Granti i parë është "programuar", që do të thotë se është caktuar për përfitues

të ndryshëm në Kosovë, por paratë ende nuk janë transferuar.

Sipas zyrtarëve të BE-së, të kontaktuar nga Radio Evropa e Lirë, as hapi formal për të "programuar" grantin e dytë nuk është bërë akoma, edhe pse pritet të kryhet si formalitet gjatë janarit.

Pasi këto masa janë vendosur në mënyrë të paprecedentë në vitin 2023, në Bruksel është duke u diskutuar edhe për atë se çfarë duhet bërë teknikisht për t'i hequr ato.

Për shembull, a duhet që shtetet anëtare të BE-së të konsultohen sërish me shkrim apo përmes ndonjë grupi pune apo komiteti të Këshillit, apo Komisioni mund të vazhdojë pa marrë miratimin e tyre?

Ajo që dihet me siguri është se Komisioni Evropian dëshiron të rifillojë të angazhohet me Kosovën.

Pak njerëz në Bruksel besojnë se Kosova dhe Serbia do të jenë të gatshme të angazhohen së shpejti në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve mes tyre, por të dërguarit të Brukselit për këto bisedime, diplomatit danez, Peter Sorensen, së fundmi i është rinovuar mandati edhe për dy vjet.

Besohet se Kaja Kallas, e cila ende nuk ka ndërmjetësuar ndonjë rund dialogu në nivelin më të lartë politik, do të përpiqet të arrijë diçka në Ballkanin Perëndimor, pas një fillimi të vështirë që ka pasur si diplomate kryesore e BE-së.

Marrë parasysh se Brukseli është anashkaluar shpesh në çështje si: bisedimet për paqe për Ukrainën, lufta në Gazë dhe situata në Iran, zyrtarët e BE-së thonë me shaka se arritja e një marrëveshjeje mes Kosovës dhe Serbisë

mund të jetë "fryti më i lehtë" që mund ta arrijë blloku në këtë moment.

Ekziston gjithashtu mundësia që shtetet anëtare të BE-së të bien dakord për ta dërguar aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE te Komisioni Evropian, në mënyrë që ekzekutivi i BE-së të vlerësojë nëse Prishtina mund të bashkohet me bllokun në të ardhmen.

Çekia, e cila ka pranuar aplikimin e Kosovës gjatë kryesimit të saj me BE-në më 2022, ka qenë vendi i fundit që ka bërë përpjekje reale për ta trajtuar këtë çështje.

Pesë shtetet e BE-së që nuk e njohin Kosovën - Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja - kanë bllokuar çdo përparim dhe ua kanë bërë të qartë vendeve të tjera anëtare që kanë pasur presidencën e radhës, se nuk do ta trajtojnë këtë çështje.

Pritjet janë që gjërat të mos lëvizin gjatë gjysmës së parë të këtij viti, ndërsa ndryshime mund të ketë kur Irlanda ta marrë presidencën në muajin korrik.

Dublina e ka bërë të qartë se po punon për t'i përfunduar negociatat për anëtarësimin e Malit të Zi në BE deri në fund të vitit dhe se synon të afrojë edhe Shqipërinë, Moldavinë dhe Ukrainën me bllokun.

Me zgjerimin e BE-së si një nga prioritetet kryesore, Irlanda mund të nisë gjithashtu edhe një vlerësim për Kosovën.

Sipas thashethemeve në Bruksel, Spanja - shpesh më e vështira mes pesësesh që s'e njeh Kosovën - mund të lejojë që Komisioni ta bëjë një vlerësim, për aq kohë sa një gjë e tillë nuk i detyron shtetet anëtare ta diskutojnë menjëherë çështjen e njohjes së Kosovës.

MIDIS MOSMARRËVESHJEVE DHE BASHKËPUNIMIT: RAPORTET E KOMUNAVE NË VERI DHE QEVERISË SË RE

Lista Serbe në fillim të dhjetorit të vitit të kaluar mori pushtetin në komunat në veri të Kosovës. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka një qëndrim kritik ndaj saj dhe nuk e dëshiron atë si partnere në ekzekutivin e tij



PRISHTINË, 12 JANAR - Respektimi strikt i ligjit dhe trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve, pavarësisht prej përkatësisë së tyre etnike, janë çelësi i bashkëpunimit ndërmjet komunave të banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës, vlerëson për Radion Evropa e Lirë ish-nënkryetari i Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Veriut, Skënder Sadiku. Ai shpreson që politikanët nga partia më e madhe e serbëve në Kosovë, Lista Serbe, dhe nga partia fituese e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit, Lëvizja Vetëvendosje (LV), “e kanë mësuar mësimin”, dhe se do t’i lënë mënjane mosmarrëveshjet në dobi të të gjithë qytetarëve. Lista Serbe në fillim të dhjetorit të vitit të kaluar mori pushtetin në komunat në veri të Kosovës, prej nga ishte larguar vetë në nëntor të vitit 2022 në shenjë proteste ndaj vendimeve të Qeverisë së Kosovës. Deri tani, Lista Serbe e ka akuzuar qeverinë e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, për “represion” ndaj popullatës serbe për shkak të zbatimit të disa vendimeve dhe mbylljes së institucioneve që funksionojnë sipas sistemit të Serbisë. Nga ana tjetër, kryeministri në detyrë ka një qëndrim kritik

ndaj Listës Serbe dhe nuk e dëshiron atë si partnere në ekzekutivin e tij. Në paraqitjet publike, ai këtë parti zakonisht e përshkruan si një “instrument politik” të Beogradit. Anëtarët e LV-së në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve gjatë vitit 2025 u përpoqën tri herë ta pengonin Listën Serbe që të merrte pjesë në zgjedhje. Udhëheqësi i kësaj partie, Kurti, gjatë fushatës parazgjedhore për zgjedhjet lokale të mbajtura më 2025 i bëri thirrje komunitetit serb të mos u besojë “thirrjeve luftënxitëse të zyrtarëve të ndryshëm të lartë nga Beogradi” dhe tha se nuk e pranon që një parti e vetme, përkatësisht Lista Serbe, të ketë “monopol mbi votat dhe përfaqësimin e komunitetit serb”. Aleksandar Rapajiq nga Qendra joqeveritare për Avokim të Kulturës Demokratike, me seli në Mitrovicën e Veriut, vlerëson se në periudhën e ardhshme do të ketë përplasje ndërmjet komunave në veri dhe Qeverisë qendrore në Prishtinë, veçanërisht midis pushteteve lokale dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Lista Serbe më herët ka paralajmëruar se do të shfuqizojë disa vendime të marra nga kryetarët shqiptarë të komunave në veri, gjatë

periudhës nga maji i vitit 2023 deri në tetor të vitit 2025. Në mesin e dhjetorit të vitit 2025, asamblistët në Mitrovicën e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok votuan për dalje nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, por që ky vendim të jetë i vlefshëm, duhet të miratohet edhe nga ministria përkatëse. “Mosmarrëveshje” pati edhe më 6 janar, në prag të Krishtlindjes Ortodokse, kur kryetari i Mitrovicës së Veriut, Millan Radojeviq, miratoi vendosjen e një pankarte me përshëndetjen fetare “Paqja e Zotit, Krishti u lind”, gjë që Policia e Kosovës fillimisht nuk e lejoi, duke arsyetuar se nevojitej edhe leja e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Megjithatë, pas disa orësh Policia ia ktheu pankartën Listës Serbe, e cila më pas e vendosi atë në qendër të qytetit.

“Bashkëpunimi nuk ka alternativë”

Radio Evropa e Lirë iu drejtua me pyetje Listës Serbe dhe Qeverisë në detyrë të Kosovës lidhur me bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë, por ato nuk janë përgjigjur. Nga Bashkimi Evropian, pas zgjedhjeve lokale të mbajtura në tetor të vitit 2025, thanë për

Radion Evropa e Lirë se presin që pushteti i sapozgjedhur lokal në veri të Kosovës, në bashkëpunim me institucionet qendrore, në periudhën e ardhshme t’i qasen “në mënyrë konstruktive zgjidhjes së nevojave dhe kërkesave të popullatës përmes institucioneve dhe në përputhje me ligjet”. Skënder Sadiku thotë se qytetarët i kanë zgjedhur përfaqësuesit e tyre si në nivel lokal, ashtu edhe në nivel qendror, dhe se ata që janë tani në pushtet duhet ta pranojnë këtë, pra që kryetarët e komunave nga Lista Serbe në veri ta pranojnë se kryeministër i të gjithë qytetarëve të Kosovës do të jetë Kurti, por edhe anasjelltas. Ai thekson se komunat në veri të Kosovës janë të banuara me shumicë serbe, por se duhet të respektohen edhe të drejtat e komuniteteve joshumicë. E njëjta gjë, sipas Sadikut, vlen edhe për institucionet qendrore, Qeveria e Kosovës duhet t’i respektojë të drejtat e komunitetit serb në gjithë territorin e Kosovës. Sadiku nënvizon se politikanët duhet të përqendrohen në nevojat reale të qytetarëve, duke përmendur se ditët e fundit të gjithë po përballen me vërshime si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut, gjë që duhet të jetë

prioritet. “Një komunë e vogël si Mitrovica e Veriut nuk mund t’u ndihmojë vetë njerëzve. Duhet të përfshihen agjencitë dhe ministritë përkatëse. Kjo është demokraci, ligjet duhet të respektohen si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal”, thotë Sadiku. Për këtë arsye, shton ai, bashkëpunimi mes pushtetit qendror dhe atij lokal nuk ka alternativë. “Ne ndajmë të njëjtin fat. Tani ka vërshime kudo. Në Mitrovicën e Veriut, serbët, boshnjakët dhe shqiptarët kanë të njëjtat probleme. Ka 1 milion tema që na ndajnë, por edhe 1 milion halle që duhet t’i tejkalojmë së bashku. Nuk guxojmë t’ua lëmë inatin brezave të ardhshëm. Zgjedhjet janë mbajtur dhe kanë përfunduar, tani situata duhet të normalizohet”, porosit Sadiku.

Bashkëpunimi i pushtetit qendror dhe lokal përmes Asociacionit

Aleksandar Rapajiq vlerëson se komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës nuk mund të kenë bashkëpunim cilësor me Qeverinë qendrore, pavarësisht se kush e udhëheq atë. Prandaj, sipas tij, është e domosdoshme formimi i Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe, për të cilën Kosova dhe Serbia janë pajtuar në kuadër të dialogut për normalizim të raporteve, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. “Me formimin e këtij trupi të ndërmjetëm midis pushtetit qendror dhe atij lokal, bashkëpunimi do të ishte shumë më i lehtë dhe më i mirë”, vlerëson Rapajiq. Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të duhej t’u sigurojë serbëve në Kosovë një nivel të caktuar vetëmenaxhimi. Statuti i Asociacionit, i hartuar nga BE-ja, parasheh rregullimin e pozitës së komunitetit serb, mbrojtjen e të drejtave të tyre, si dhe financimin nga Serbia. Statuti saktëson se Asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe nuk do ta rrezikojë pavarësinë dhe integritetin territorial të Kosovës si dhe parashikon që dokumenti t’i nënshtrohet vlerësimit nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Rama: Bashkëpunimi me Turqinë, i rëndësishëm për zhvillimin afatgjatë të kryeqytetit

PRISHTINË, 12 JANAR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur në takim ambasadorin e Republikës së Turqisë në

Kosovë, Tunç Angilo, i cili e uroi për fillimin e mandatit të dytë qeverisës. “Diskutuaam për vazhdimin e bashkëpunimit dhe për projektet e ardhshme

me interes të përbashkët. Partneriteti ynë ndërtohet mbi miqësinë, respektin reciprok dhe angazhimin e përbashkët për rezultate konkrete për

qytetarët. Bashkëpunimi me Turqinë mbetet i rëndësishëm për zhvillimin dhe vizionin afatgjatë të kryeqytetit”, ka thënë Rama pas takimit.



KUVENDI KOMUNAL I MALISHEVËS FORMOI KOMITETET OBLIGUESE



MALISHEVË, 12 JANAR - Kuvendi i komunës së Malishevës, në mbledhjen e parë urgjente të kryesuar nga kryesuesi Fatmir Ademaj në këtë seancë, ka miratuar vendimin për formimin e komiteteve obliguese në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit. Me këtë vendim janë themeluar

komitetet: Komiteti për Politikë dhe Financa, i cili në përbërje ka shtatë anëtarë si dhe Komiteti për Komunitete që ka pesë anëtarë, ndërsa për komitete të tjera funksionale sipas nevojës së Kuvendit. Anëtarët e komiteteve u propozuan nga grupet e këshilltarëve dhe u miratuan me votë. Kryesuesi i Kuvendit theksoi se

formimi i komiteteve është hap i rëndësishëm për funksionimin demokratik të Kuvendit, rritjen e transparencës dhe shqyrtimin profesional të çështjeve që prekin qytetarët e komunës. Komitetet pritet ta nisin punën menjëherë, duke trajtuar temat kryesore për zhvillimin lokal, buxhetin, shërbimet publike dhe çështjet e komuniteteve.

SAFET KAMBERI ZGJIDHET KRYESUES I KUVENDIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS

MITROVICË, 12 JANAR - Nën drejtimin e anëtarit më të moshuar të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, Naser Muja, dhe në prani të kryetarit Faton Peci, si dhe asamblistëve, është mbajtur mbledhja urgjente e kuvendit të komunës. Në këtë mbledhje janë shqyrtuar dy pika të rendit të ditës: betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës, Arian Tahiri, si dhe zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të komunës.

Pas zhvillimit të procedurave të parapara, me 18 vota për të asamblistëve, Safet Kamberi nga radhët e LDK-së është zgjedhur kryesues i kuvendit komunal. Kryesuesi i sapozgjedhur, Safet Kamberi, falënderoi të gjithë asamblistët për besimin e dhënë, duke premtuar se do të angazhohet për ruajtjen e frymës demokratike të punës dhe bashkëpunim të hapur me të gjithë këshilltarët e kuvendit të komunës.



PREBREZA TAKON PËRFAQËSUESIT E KOMUNITETEVE PAKICË, DISKUTOJNË PËR GJENDJEN E KOMUNITETEVE NË FUSHË-KOSOVË



FUSHË-KOSOVË, 12 JANAR - Kryetari i komunës së Fushë-Kosovës, Valon Prebreza, ka zhvilluar takime zyrtare me përfaqësuesit e komuniteteve pakicë që jetojnë në komunën e Fushë-Kosovës, përkatësisht komunitetin ashkali, egjiptian, serb dhe rom. Gjatë takimeve u diskutua për gjendjen e përgjithshme të komuniteteve pas vërshimeve të fundit që kanë prekur komunën, me theks të veçantë

në nevojat emergjente dhe sfidat aktuale. Po ashtu, u mbajtën konsultime lidhur me procesin e zgjedhjes së nënkryetarit të komunës nga radhët e komuniteteve pakicë, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Takimet u zhvilluan në frymë bashkëpunimi institucional dhe dialogu konstruktiv, parime që do të udhëheqin edhe të gjitha proceset dhe vendimmarrjet e ardhshme.

AAK-ja merr drejtimin e Kuvendit Komunal të Junikut, Leonard Lolluni zgjidhet kryesues

PRISHTINË, 12 JANAR - Kuvendi Komunal i Junikut me shumicë votash ka zgjedhur kryesuesin e ri të Kuvendit, Leonard Lolluni, njëherësh

kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Junik. Zgjedhja e Lollunit vjen pasi subjekti që ka pushtetin në

Junik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk ka arritur ta sigurojë shumicën e nevojshme në Kuvendin Komunal.

Ndërkaq Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka arritur ta formojë shumicën, duke marrë drejtimin e Kuvendit Komunal të Junikut.



LUMIR ABDIXHIKU E PASKE KALUAR VIJËN, RËNDË DHE PA KTHIM



Shkruan: Hisen BERISHA

Ke shkuar larg. Shumë larg. Dhe ke shkelur rëndë me atë deklaratë, Lumir Abdixhiku. Prita dy ditë pa reagu. Jo nga hezitimi, por nga shpresa se do të flisnin vëllezërit e mi të armës, ata që ende janë brenda asaj shtëpie politike që dikur mishëronte vizionin për pavarësi dhe shtet të Kosovës. Prita që nga brenda LDK-së të vinte një reagim kundër një gjuhe që fyen luftën, përçmon sakrificën dhe godet themelet mbi të cilat u ndërtua ky shtet. Por heshtja që mbretëroi brenda asaj shtëpie, dikur rugoviane, tashmë nuk është më thjesht devijim filozofik. Ajo heshtje është rreshtim. Është bërë një me kundërshtarët e luftës, të lirisë, të pavarësisë dhe të vetë shtetit të Kosovës, një shtet që u ngrit mbi parimet rugoviane të lirisë, barazisë dhe demokracisë. Përdorimi i termit “mercenar”,

në kuptimin e tij të pastër luftarak, person që lufton për para, pa ndjenjë detyre kombëtare, patriotike, atdhetare apo kushtetuese, nuk është lapsus gjuhësor. Është zgjedhje politike. Është akt i qëllimshëm. Është e shtënë me pushkë gjuetie, jo në thëllëza, por në shqiponjat e lirisë. Dhe këtu nuk ka rëndësi konteksti. Nuk ka asnjë dilemë se ti, Lumir Abdixhiku, bashkë me Vjosa Osmanin dhe Albin Kurtin, përbëni të njëjtën strukturë ideologjike sorosiane, e cila ka për synim stërkeqjen e shtetit të Kosovës dhe zhvendosjen e tij drejt nostalgjisë jugosllave. Prandaj edhe rikthimi i luftës politike kundër figurave shtetformuese, si Ismailqemal Vlorë kosovar, apo Hashim Thaçi, shqiptari i Kosovës, është dëshmi besnikërie para padronëve tuaj ideologjikë dhe

një abuzim i hapur me vetëdije stokholmiane për t’u bërë krah politik dhe qeverisës në procesin e zhbërjes së shtetit. Ky mision mbi trinom tipik pravosllav, Kurti, Osmani, Abdixhiku, u dëshmuar qartë edhe në zgjedhjet e shkurtit 2025, kur refuzuat bashkimin e së djathtës popullore dhe të djathtës konservatore për ta bërë qeverinë. Por për këtë, rugovistët e vërtetë, dishepujt e presidentit historik Ibrahim Rugova, dhanë verdiktin e tyre më 28 dhjetor 2025. Ajo që kam pritur nga vëllezërit e armës brenda subjektit historik të Presidentit Rugova, luftëtarë të lirisë në radhët e UÇK-së, ishte që ti të mos guxoje kurrë më të shkelje në zyrat e LDK-së, përveçse për të dhënë dorëheqje dhe për t’iu bashkuar hapur, kolaboracionisht, ekipit sorosian Kurti-Osmani & Co., që sot po e mbajnë peng të

ardhmen e Kosovës. Por historia nuk rishkruhet. Çdo epokë i ka heronjtë e vet. Ashtu siç i ka për nder e lavdi, i ka edhe për faqe të zezë dhe tradhti. Vitet ’90 filluan me heroin vizionar Ibrahim Rugova dhe kulmuan me Kryeheroïn Hashim Thaçi, me Kryekomandantët Sali Çeku, Adem Jashari, Zahir Pajaziti dhe dhjetëra figura të tjera të lavdishme, të rëna dhe të gjalla, të luftës për liri. Prandaj, rifillimi i kësaj “luftime” kundër së djathtës konservatore dhe luftëtarëve, me automatizëm ju rreshton krah atyre që ditën e çlirimit e kanë 14 shkurtin dhe shtetin e Kosovës e shohin vetëm brenda ofertës së Millosheviqit për “Republikën e tretë”, ku nuk ka vend për Lëvizjen Rugoviane. Me këtë doktrinë politike, qarqe të caktuara brenda jush, bashkë

me Vjosa Osmanin, po e çojnë me sukses LDK-në drejt zhbërjes. Nëse rifilloni me këtë propagandë, atëherë vazhdoni në misionin tuaj. Pritjet ishin që të reflektoni, që t’i bashkojmë forcat për ta shpëtuar shtetin nga zhbërësit që erdhën me revolucionin e “shamijave të kuqe”. Por mos harroni një gjë: ky vend i ka ende gjallë dalëzotësit e vet. Ndoshta në përqindje po aq sa në vitet 1998/99, kur ishim vetëm 0.28% e dy milionëve, por të mjaftueshëm për ta bërë sërish dallimin. (Sepse mjeti për mbrojtjen e vlerave themelore të shtetësisë, integriteti territorial dhe sovraniteti politik, është arma, e jo vota.) E pra jo, Lum. Ata nuk janë mercenarë. Ata janë themeli mbi të cilin qëndron ende ky shtet, pavarësisht jush.

QKUK shënon rekord në vitin 2025 me mbi 400 operime kardiokirurgjike

Prishtinë, 12 janar - Shërbimi Klinik i Kardiokirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) gjatë vitit 2025 ka shënuar rekord me realizimin e mbi 400 operimeve kardiokirurgjike, duke përfshirë raste elektive dhe emergjente, në përputhje me standardet bashkëkohore të kardiokirurgjisë. Gjatë vitit 2025 janë kryer me sukses ndërhyrje të ndërlikuara kardiokirurgjike,

përfshirë për herë të parë në Kosovë operacionin e harkut të aortës me teknikën Frozen Elephant Trunk (FET) si dhe një rast tjetër me David procedurë, në bashkëpunim me qendra të njohura evropiane. Po në muajin maj dhe tetor, në bashkëpunim me kardiokirurgë pediatrikë ndërkombëtarë, janë realizuar 19 operime te fëmijët me defekte të lindura të zemrës.

Shërbimi Klinik i Kardiokirurgjisë ka njoftuar se vazhdon të shënojë rritje të cilësisë së shërbimeve dhe besimit nga pacientët, duke u angazhuar për rezultate edhe më të mira në vitet në vijim. “Stafi u bën thirrje qytetarëve të Republikës së Kosovës që për trajtimin e sëmundjeve të zemrës të drejtohen në QKUK, pa pasur nevojë për trajtim jashtë vendit”, ka njoftuar QKUK-ja.



EKONOMIA E KOSOVËS NË DEKADËN E FUNDIT: RITITJE NË SHIFRA, ULJE NË JETËN REALE



PRISHTINË, 12 JANAR - Ekonomia e Kosovës në dekadën e fundit ka kaluar nëpër faza të ndryshme të zhvillimit: rritje, ulje, stagnim dhe kriza.

Edhe pse të dhënat zyrtare të institucioneve të Kosovës tregojnë se ka rritje të disa indikatorëve ekonomikë, në terren vazhdojnë ankesat e qytetarëve për përkeqësim të standardit të jetesës.

Viti 2025 është mbyllur me rritje ekonomike prej 3.9-përqindësh dhe parashikimet e Bankës Qendrore të Kosovës janë që këtë vit kjo shifër të arrijë në 4.1 për qind.

Rritja, sipas BQK-së, do të mbështetet te konsumi privat, rimëkëmbja graduale e eksportit dhe zbutja e inflacionit. Por, në vitet e fundit - sidomos pas pandemisë Covid-19 në vitin 2020 dhe nisjes të pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës nga Rusia më 2022 - shtrenjtimi i produkteve dhe shërbimeve esenciale ishin ndër temat më të përfolura në Kosovë.

Qytetarët shpesh janë ankuar se inflacioni ka ulur fuqinë e tyre blerëse, duke i detyruar shumë prej tyre të heqin dorë nga produkte dhe shërbime, pasi që pagat nuk mjaftojnë për t'i

përballuar të gjitha shpenzimet e nevojshme.

Ndërkohë, zyrtarë të institucioneve të Kosovës kanë theksuar se inflacioni vjen për shkak të varësisë së vazhdueshme të shtetit nga importi i produkteve të huaja.

Me qëllim zbutjen e inflacionit, Qeveria e Kosovës ka rritur pagat në sektorin publik. Ndërkaq, sektorin privat ka tentuar ta ndihmojë me platformën "Superpuna", e cila ka nisur në vitin 2023.

Përmes kësaj platforme qeveria subvencionon punëdhënësin duke paguar pagën e punëtorit për gjashtë muajt e parë, në vlerë të pagës minimale prej 350 eurosh. Punëdhënësi, pastaj, ka të drejtë ta shtojë vlerën e pagës për punëtorin e angazhuar.

Por, kjo rritje e pagave, sipas ekspertëve të ekonomisë, nuk është përkthyer në përmirësimin e standardit të jetesës së qytetarëve për shkak të inflacionit të lartë.

Në vitin 2025 numri i të punësuarve ka kaluar mbi 400 mijë, duke vazhduar kështu trendin e rritjes së numrit të punësuar me kontratë formale. Ndërkaq, në mesin e personave të papunë ka më së shumti gra të cilat mbajnë barrën më të

madhe për kujdesin ndaj familjes dhe fëmijëve.

Numri i vogël i çerdheve, sidomos në zonat rurale, vlerësohet si një ndër faktorët që ka pamundësuar që gratë të futen në tregun e punës.

Një çështje nga e cila vuan ekonomia e Kosovës, sipas ekspertëve të fushës, është sasia e lartë e produkteve të importuara nga tregjet e huaja.

Me gjithë mbështetjen e prodhuesve kosovarë, ende nuk është arritur të ndryshohet deficitit tregtar për shkak të kapaciteteve të kufizuara prodhuese.

Vlera e importit tashmë ka arritur në gjashtë miliardë, derisa vlera e produkteve të Kosovës që kanë dalë në tregjet e jashtme është më pak se një miliard euro.

Nga viti 2017 deri në nëntor 2025, vlera totale e energjisë elektrike të importuar nga Kosova ka kaluar një miliard euro. Në të njëjtën periudhë, eksportet e vendit arritën në 367.4 milionë euro, duke krijuar një diferencë neto prej rreth 675 milionë eurosh.

Investimet e huaja në Kosovë konsiderohen shtytës i zhvillimit ekonomik. Megjithëse, viteve të fundit ka rritje të investimeve të

huaja direkte sipas shifrave zyrtare, por kjo gjithmonë ka nxitur diskutime se shumica vijnë nga diaspora që investon në patundshmëri.

Si pengesë për investitorët e huaj në Kosovë janë përmendur më parë procedurat e shumta burokratike, ndërkohë që në vitet e fundit është rritur vlera e investimeve nga Kosova jashtë vendit.

Paratë e diasporës dërguar familjarëve të tyre në Kosovë mbeten një ndër shtyllat kryesore të ekonomisë në vend. Remitencat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve, duke zvogëluar varfërinë dhe rritur konsumimin.

Por, jo gjithmonë është lavdëruar mënyra e shfrytëzimit të këtyre mjeteve, pasi që është kërkuar ndërrimi i fokusit. Sipas ekspertëve, investimi në projekte kapitale do të ndikonte në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Sfida kryesore mbetet përkthimi i rritjes ekonomike në mirëqenie reale, përmes rritjes së prodhimit vendor, pagave të qëndrueshme, uljes së varësisë nga importi dhe krijimit të një klime më të favorshme për investime afatgjata.

PRODIMI I BRENDSHËM BRUTO

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) në Kosovë ndër vite ka shënuar rritje. Nga 5.6 miliardë, sa ka qenë në vitin 2015, tani ka arritur në 11.1 miliardë euro.

Rritja ekonomike

Kosova ka shënuar vazhdimisht rritje ekonomike, përveç në vitin 2020 kur u godit nga pandemia Covid-19. Por, ekspertët e ekonomisë vazhdimisht kanë thënë se kjo rritje duhet të jetë në shifra dyshifrore për të ndikuar tek mirëqenia e qytetarëve.

Inflacioni

Viti 2025 u përmbyll me normë të inflacionit prej 3.9 për qind. Për vitin 2026, Banka Qendrore e Kosovës parashikon që inflacioni të ulet në 3.4 për qind.

Paga mesatare bruto

Gjatë këtij viti në Kosovë, punonjësit në sektorin publik i kanë marrë pagat me rritje prej 100 eurosh, që ka kontribuar në rritjen e mëtejshme të pagës mesatare.

Shkalla e punësisë dhe papunësisë

Shkallët e punësisë dhe papunësisë kanë ndjekur trende të ndryshme gjatë dekadës së fundit. Përderisa shkalla e punësisë ka shënuar rritje graduale, shkalla e papunësisë ka pësuar rënie.

Remitencat

Vlera e remitencave në Kosovë ka ndjekur vazhdimisht një trend rritjeje. Vetëm gjatë periudhës janar-tetor të vitit 2025, vlera kishte shkuar në gati 1.2 miliard euro. Por, vetëm për vitin 2025 nuk ka ende të dhëna për muajt nëntor dhe dhjetor.

Më shumë vizitorë në hotele në nëntor 2025 krahasuar me një vit më parë

PRISHTINË, 12 JANAR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e hotelevisë për muajin nëntor 2025.

Në nëntor 2025 numri i vizitorëve (vendorë dhe të huaj) në hotele ishte 57 548, prej tyre 42,8 % ishin vendorë dhe 57,1 % ishin të jashtëm. Krahasuar me muajin nëntor

të vitit 2024 (sa ishin 56 027 vizitorë) pati rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve në hotele për 2,7 %.

Numri i net-qëndrimeve ishte 120 210, prej tyre 50,3 % nga vendorët dhe 49,7 % nga të huajt.

Numrin më të madh të vizitorëve te brendshëm në hotele e ka rajoni i Pejës me 7

140 vizitorë dhe me 25 108 net-qëndrime.

Sa iu përket vizitorëve të huaj, krahasuar me periudhën paraprake (nëntor 2024), pati rritje të vizitorëve për 2,1 %. Në total ishin 32 909 vizitorë të huaj nga të cilët numri më i madh është nga: Shqipëria, Turqia, Zvicra, Gjermania etj.



PIJA ALKOOLIKE QË PO ‘NDEZ GJAKRAT’ MES KINËS DHE JAPONISË



Në pamje të parë duket si një mosmarrëveshje tregtare e rëndomtë, por pas shisheve të bllokuara të sakes fshihet një nga krizat më të rënda diplomatike të viteve të fundit. Pija kombëtare japoneze, një alkool i prodhuar nga orizi, është bërë viktimë e papritur e një lufte nervash mes Pekinit dhe Tokios, duke treguar se si këtë vit, tregtia po përdoret si një “kamxhik politik”.

“Hakmarrja” që nis në dogana

Gjithçka nisi pas deklaratave të forta të Kryeministres japoneze, Sanae

Takaichi, mbi mbrojtjen ushtarake të Tajvanit. I irrituar nga ajo që e konsideron “ndërhyrje”, Pekini ka zgjedhur një rrugë të tërthortë për të goditur: bllokimin e produkteve ushqimore japoneze. Sipas agjencisë së lajmeve Kyodo, procedurat doganore për saken në portet kineze janë dyfishuar në kohë, duke u zvarritur për javë të tëra nën një “dembelizëm” burokratik të qëllimshëm që synon të gjunjëzojë eksportuesit japonezë. Kina mbetet tregu kryesor i kësaj pije, me një vlerë prej 11.6 miliardë jen (75 milion euro), dhe ky bllokim godet drejtpërdrejt ekonominë rurale japoneze.

Lufta përtej alkoolit

Por sakeja është vetëm maja e ajsbergut. Sherri është përshkallëzuar në sektorë jetikë si ai i gjysmëpërçuesve dhe mineraleve të rralla. Kina i ka shtrënguar ndjeshëm dhënien e licencave të eksportit për metalet që Japonia i përdor në industrinë e saj të mbrojtjes dhe teknologjisë së lartë. Si kundërpërgjigje, Japonia po përgatit anijen “Chikyu” për të nisur operacionin e parë në botë të kërkimit të minieraleve në det të thellë, deri në 6.000 metra thellësi, duke tentuar të thyejë varësinë prej 70 për qind nga

importet kineze.

Një kërcënim që po rritet

Përtej shifrave, situata në terren është e tensionuar. Pekini denoncon “demonët militaristë” të Tokios, ndërsa një sondazh i fundit tregon se 68 për qind e japonezëve e shohin fuqinë ushtarake kineze si kërcënimin numër një. Ajo që nisi me bllokimin e një pije alkoolike, po rezulton të jetë një betejë për dominim në Azi. Viti 2026, po na tregon se kur mungon dialogu, edhe një produkt tradicional mund të shërbejë si shkrepëse për të ndezur zjarrin e një konflikti global.





Muriqi e gjen golin e 45-të te Mallorca, i afrohet rekordit të legjendarit Eto'o

MALLORCA, 12 JANAR - Sulmuesi i Kombëtares së Kosovës, Vedat Muriqi, ka vazhduar formën e shkëlqyer këtë sezon në La Liga, duke shënuar golin e 11-të për Mallorcan këtë sezon në përballjen ndaj Rayo Vallecanos. Kësisoj, ai shkon në 45 gola me fanellën e Mallorcas në La Liga. Tani sulmuesi i Kosovës është vetëm nëntë gola larg rekordit të legjendës, Samuel Eto'o.



OSMANI DEKORON ARATIN PËR KONTRIBUTIN NË KANDIDIMIN E KOSOVËS PËR ORGANIZIMIN E LOJËRAVE MESDHEHETARE



PRISHTINË, 12 JANAR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka dekoruar personalitetin botëror të sportit, Hasan Arat, në vlerësim të kontributit të tij të çmuar në sportin ndërkombëtar, si dhe të rolit dhe përkushtimit të tij në procesin e kandidimit të Kosovës për organizimin e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030. Osmani ka theksuar i se Arat ka dhënë kontribut të çmueshëm në promovimin e sportit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, duke kulmuar me angazhimin e tij që Kosova

ta fitojë të drejtën e organizimit të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030. Arat është shprehur i nderuar me marrjen e Medaljes Presidenciale, duke shtuar se promovimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare e bën me shumë zell, derisa ka theksuar se populli i Kosovës duhet të ndihet krenar me të arriturat në sport si dhe me organizimin e Lojërave Mesdhetare që do të bëhet pas katër vjetësh. Arat është afarist dhe administrator sportiv nga Turqia, por me prejardhje

shqiptare. Në karrierën sportive ka qenë basketbollist, ndërsa si udhëheqës është anëtar i Komitetit Olimpik të Evropës, ish-nënpresident i Komitetit Olimpik të Turqisë, kryetar i komisionit koordinues për Lojërat Evropiane Krakow 2023, udhëheqës i kandidaturës së Stambollit për organizimin e LO 2020, ish-anëtar i komisioneve të ndryshme në IOC e ANOC, anëtar i Komitetit Ekzekutiv në Federatën Botërore të Atletikës etj. Së fundi (2023-2024), e për më shumë se një vit, ishte president i klubit të madh turk të futbollit, Beshiktash.

PRESIDENTI I FFK-së VIZITON PEJËN DHE NDERON FISNIK ADEMIN

PEJË, 12 JANAR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, së bashku me futbollistët e gjeneratës së artë, ka qëndruar në Pejë. Ai ka theksuar se Peja është një nga qytetet më pitoreske të Kosovës dhe vatër e rëndësishme e talenteve të futbollit. Ai ka shkruar për njërin prej futbollistëve më të shquar që ka pasur vendi ynë, Fisnik Ademin. "Ai i përket gjeneratës së artë të futbollit kosovar. Në kohën kur luante, talenti, inteligjenca në lojë dhe niveli i lartë profesional e bënin atë një idhull për të rinjtë, derisa pa dyshim se për nivelin e lojës mund të



krahasohet me emra të mëdhenj të futbollit botëror si Zidane, Ronaldo, Messi, Iniesta

e të tjerë. Ai ka lënë gjurmë të pashlyeshme në KF Trepça, si një mesfushor jashtëzakonisht

inteligjent, kapiten, lider dhe unifikues në fushë, i cili gjithmonë ka ditur çfarë duhet

bërë me topin", ka shkruar Ademi në "Facebook". Ai ka theksuar se kontributi i tij nuk ka qenë vetëm sportiv. "Fisnik Ademi ka luajtur rol kyç në inkurajimin e futbollistëve të rinj nga trevat shqiptare që t'i bashkohen KF Trepça, në një kohë kur klubi kishte vetëm dy futbollistë shqiptarë, duke ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin dhe konsolidimin e futbollit vendor", ka shkruar Ademi, duke bërë me dije se ia ka dhuruar topin zyrtar të Superligës, si simbolikë e lidhjes së tij të veçantë me lojën dhe mjeshtërinë që e ka karakterizuar gjithmonë në fushën e gjelbër.

Barcelona fiton Superkupën, mposht Real Madridin

JEDDAH, 12 JANAR - Skuadra e Barcelonës e ka nisur vitin 2026 në mënyrën më të mirë të mundshme, me triumfin në Superkupën e Spanjës. Në finalen e luajtur të dielën mbrëma në Jeddah të Arabisë Saudite, Barcelona fitoi me rezultatin e ngushtë 3:2 ndaj Real Madridit. Për Barcelonën ky është trofeu i parë i këtij viti dhe fitorja e parë në "El Clasicon" e vitit 2026. Ndeshja e luajtur në Arabinë Saudite ishte tejet e fortë dhe interesante, me një fjalë spektakël i vërtetë nga të dyja skuadrat në fushë. Megjithatë, pjesa e parë ishte

dukshëm më dinamike sesa e dyta, në të cilën u shënuar vetëm një gol. Në pjesën e parë janë shënuar gjithsej katër gola, dy nga Barcelona dhe dy të tjerë nga Real Madridi. Në fakt, Barcelona dy herë ka kaluar në epërsi gjatë pjesës së parë, por Real Madridi reagoi duke barazuar rezultatin në të dyja rastet. Madje tre prej katër golave janë shënuar në gjashtë minutat shtesë të pjesës së parë. Rezultati është zhbllokuar në minutën e 36 nga Raphinha (1:0), përpara se Vinicius Junior t'i barazonte shifrat (1:1) me

supergol në minutën e dytë të kohës shtesë. Në minutën e katërt të kohës shtesë, Robert Lewandowski ka rikthyer epërsinë e Barcelonës (2:1) përpara se Gonzalo Garcia dy minuta më vonë të barazojë dhe skuadrat të shkojnë në pushim me shifrat 2:2. Golin e fitores, që edhe ia ka siguruar Barcelonës triumfin në Superkupë, e ka realizuar braziliani Raphinha në minutën e 73-të pas asistimit të Dani Olmos. Në minutën e 90 Barcelona ka mbetur me një lojtar më pak pasi është përjashtuar kapiteni Frenkie De Jong. Te Real Madridi në 15



minutat e fundit të ndeshjes është inkuadruar Kylian Mbappe, i cili ka zëvendësuar Kylian Garcian.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Solar's L.L.C”, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për sistemi solar me paisje fotovoltaike për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme elektrike me kapacitet 8951 kWp ~ 9 MWh, zona kadastrale Kodra e Hutit, Madanaj-Rrypaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.02.2026 në ora 11:00 në Objektin e Komunës së Gjakovës, do të organizohet debat publik nga “Solar's L.L.C”, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/9535257790?pwd=dAFk8wyqrcGJk62TC60ZQRNyqoJzhk>

Meeting ID: 9535257790

Pascode: 000000

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Solar's L.L.C”, Gjakovë, për Pëlqim Mjedisor, për sistemi solar me paisje fotovoltaike për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme elektrike me kapacitet 8951 kWp ~ 9 MWh, zona kadastrale Kodra e Hutit, Madanaj-Rrypaj.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Solar's L.L.C”, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për sistemi solar me paisje fotovoltaike për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme elektrike me kapacitet 8951 kWp ~ 9 MWh, zona kadastrale Kodra e Hutit, Madanaj-Rrypaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.02.2026 në ora 11:00 në Objektin e Komunës së Gjakovës, do të organizohet debat publik nga “Solar's L.L.C”, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/9535257790?pwd=dAFk8wyqrcGJk62TC60ZQRNyqoJzhk>

Meeting ID: 9535257790

Pascode: 000000

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Solar's L.L.C”, Gjakovë, për Pëlqim Mjedisor, për sistemi solar me paisje fotovoltaike për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme elektrike me kapacitet 8951 kWp ~ 9 MWh, zona kadastrale Kodra e Hutit, Madanaj-Rrypaj.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Muhamet Z. Mehmeti B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr: 330303256.

- Ardita Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të sh.m.l. “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Hektor Radoniqi B.I. shpall të pavlefshme numrin e certifikatës së biznesit 811147306 të lëshuar nga ARBK.

- Sadri Muhadri Damjan Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u “Hamëz Cena” Damjan.

- Petrit Muhadri Damjan Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Pjeter Bogdani” Damjan Gjakovë.

- Imer Shala shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Vlora Ibrahim shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues: 811953662.

- “Red Global” L.L.C. emri Tregtar Yummi Yummi Doner shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 812314772.

- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Pjeter Bogdani” Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Krenar Abrashi” B.I. me nr. Unik: 811133719.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI "MITROVICA" SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.O.



03-10
Data: 12.01.2026

Në bazë të funksioneve dhe kompetencave që parashihen në nenin 21, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr.03/L-087), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009 për NP, Komisioni i Auditimit të KRU "Mitrovica" Sh.A., vendosi të shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

Titulli i punës : Zyrtar/e i/e Auditimit të Brendshëm
Vendi: Mitrovicë-Suhodoll
Ndërmarrja: Kompania Rajonale Ujësjellësi,, Mitrovica,, Sh.A.
I përgjigjet: Komisionit të Auditimit të Brendshëm të KRU"Mitrovica"Sh. A, Mitrovicë.
Paga bazë: 1153.99 euro
Mandati: 3 vite- me mundësi vazhdimi
Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:
Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (k) dhe (l) dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Diplomë universitare në **ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike** ose fusha të tjera relevante për sektorin që auditohet (kopja e noterizuar ndërsa diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të **notrifikuara** nga MASHITD);
- Certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik**, e lëshuar nga Ministria e Financave ose ndonjë institucion relevant vendor/ndërkombëtar në pajtim me kriteret e MF;
- Certifikatë Kontabilist i Çertifikuar** nga shoqata profesionale të licencuara;
- Së paku **5 vjet përvojë pune** - në një nivel të lartë të menaxhues
- Certifikatën** për Auditor të Çertifikuar (Obligative)
- Aftësi organizative, menaxhuese të njohi punën me kompjuter excel, word etj.
- Të mos ketë konflikt interesi që do ta pengonte personin në ushtrimin e rregullt, të pavarur dhe objektiv të detyrave të tij ndaj Aksionarit. Personi duhet të jetë me integritet të dëshmuar.

Funksioni dhe përgjegjësitë kryesore të Zyrtari i Auditimit të Brendshëm të përcaktuara me Statutin e kompanisë:

Zyrtari i Auditimit të Brendshëm
Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Komisionit të Auditimit, dhe duke i raportuar ekskluzivisht atij, zyrtari i auditit të brendshëm të Shoqërisë ("Zyrtari i Auditimit të Brendshëm ") do të jetë përgjegjës për:
Udhëheqjen, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të zyrës së auditimit, duke zgjedhur stafin e saj;
Udhëheq dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm; dhe
Përbush çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga ana e Komisionit të Auditimit.

Detyrat dhe përgjegjësit e Zyrtarit/es së Auditimit të Brendshëm janë:

- Përpilimin e procedurave të auditimit, gjegjësisht planit të Auditimit të Brendshëm, për të gjitha transaksionet e Kompanisë konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të Kompanisë bazuar në legjislacion të aplikueshëm,
- Shqyrtimin e planit të investimeve dhe financiar të kompanisë, planit vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor,
- Shqyrtimin e pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklarata financiare që kërkojnë me ligj,
- Vlerësimi objektiv të shfrytëzimit efektiv të burimeve të Kompanisë dhe dhënia e rekomandimeve adekuate për Komisionin e Auditimit dhe Menaxhmentin e Kompanisë,
- Verifikimin e përshtatshmërisë dhe funksionimit të rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga Kompania të gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe punëve të saj, dhe t'i sigurojë Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme,
- Verifikimin e rregullt të përshtatshmërisë dhe funksionimit të rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim që të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i Kompanisë duke përfshirë dokumentacionin financiar, mbahen në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me ligjin, dhe që projekt-deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt,
- Kryen analizë sistematike të proceseve të biznesit dhe kontrolleve të ndërlidhura me to,
- Raporton rregullisht para Komisionit të Auditimit,
- Udhëheq dhe menaxhon organizimin e brendshëm të zyrës së auditimit,
- Udhëheq dhe drejton të gjitha aktivitetet e Auditimit të Brendshëm,
- Mban raporte të mira me Komisionin e Auditimit, Auditorët e jashtëm, Menaxhmentin dhe stafin e Kompanisë,

- Përbush çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga Komisioni i Auditimit,
- Për punën që kryen i përgjigjet Komisionit të Auditimit të Brendshëm.

Procedura e aplikimit:
Dokumentet e kërkuara

Kandidatët e interesuar duhet t'i bashkëngjisnin këto dokumente:

- Aplikacionin zyrtar të KRU "Mitrovica".
- CV-në (jetë përshkrimin);
- Letër motivimi;
- Kopjen e diplomës universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike ose fusha të tjera relevante për sektorin që auditohet (kopja e noterizuar ndërsa diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHITD);
- Certifikatën për auditor të brendshëm në sektorin publik**, e lëshuar nga Ministria e Financave ose ndonjë institucion relevant vendor/ndërkombëtar në pajtim me kriteret e MF;
- Certifikatën** për Auditor të Çertifikuar (Obligative);
- Certifikatë Kontabilist i Çertifikuar** nga shoqata profesionale të licencuara;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (trustin apo kontratë pune ose vërtetim nga punëdhënësi që dëshmon funksionin menaxherial apo detyrat e punës dhe kohëzgjatjen e angazhimit).
- Deklarata nën betim e cila mund të shkarkohet nga uebfaqja e kompanisë;
- Certifikatën nga evidenca penale, jo më të vjetër se 6 muaj, që dëshmon se aplikanti nuk është dënuar me më shumë se 6 muaj burgim me vendim të formës së prerë.
- Kopjen e letërnjoftimit të lëshuar nga Republika e Kosovës.


Aplikacioni dhe Deklarata nën Betim mund të merren në ueb-faqen e Kompanisë në adresën: <https://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>.
Aplikacionet dhe dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen të skanuara ose në formatin .pdf në email adresën: rekrutimi@kru-mitrovica.com

Afati për aplikim është **30 ditë** nga data e publikimit të Konkursit Publik duke filluar nga data: **12.01.2026** deri me datën **11.02.2026** ora 24:00.

Vërejtje: Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurrimit, do të refuzohen.

KRU"Mitrovica"Sh.A. Mitrovicë-Suhodoll.





Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD "MITROVICA" A.D.



Na osnovu funkcija i ovlašćenja predviđenih članom 21, u vezi sa članom 17 Zakona o javnim preduzećima (Zakon br. 03/L-087), izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-111 i Zakonom br. 05/L-009 o JP, Odbor za reviziju KRV „Mitrovica“ A.D. donosi odluku da objavi sledeći:

JAVNI KONKURS

Naziv radnog mesta: Službenik/ca interne revizije
Mesto: Mitrovica – Suvi Do
Preduzeće: Kompanija Regionalni Vodovod „Mitrovica“ A.D.
Odgovara: Odboru interne revizije KRV „Mitrovica“ A.D., Mitrovica
Osnovna plata: 1153,99 evra
Mandat: 3 godine – sa mogućnošću produženja

Potrebni uslovi i kvalifikacije:
Odbor za reviziju želi da obezbedi da svi potencijalni kandidati budu osobe od dokazanog integriteta koje ispunjavaju uslove kvalifikacije prema članu 17.1, da ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2, tačke (d), (f), (k) i (l), kao i da poseduju neophodno profesionalno iskustvo i obrazovanje za predmetnu poziciju.

- Pored ovih opštih uslova, kandidati moraju ispuniti i sledeće posebne uslove:**
- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, prava, javne administracije, javnih finansija ili drugih relevantnih oblasti za sektor koji se revidira (overena kopija, dok diplome iz inostranstva moraju biti **nostrifikovane** od strane MASHTI-a);
 - Sertifikat internog revizora u javnom sektoru**, izdat od Ministarstva finansija ili relevantne domaće/međunarodne institucije u skladu sa kriterijumima MF;
 - Sertifikat ovlašćenog računovođe** od licenciranih profesionalnih udruženja;
 - Minimum **5 godina radnog iskustva** – na višem nivou rukovođenja;
 - Sertifikat ovlašćenog revizora** (obavezno);
 - Organizacione i menadžerske sposobnosti; poznavanje rada na računaru (Excel, Word, itd.);
 - Da ne postoji sukob interesa koji bi sprečavao lice u redovnom, nezavisnom i objektivnom obavljanju njegovih dužnosti prema Akcionaru. Lice mora imati dokazan integritet.

Glavne funkcije i odgovornosti Službenika interne revizije, utvrđene Statutom kompanije:

Službenik interne revizije
Pod rukovodstvom i nadzorom Odbora za reviziju, i izveštavajući isključivo tom odboru, službenik interne revizije društva („Službenik interne revizije“) biće odgovoran za:
Upravljanje, rukovođenje i interno organizovanje kancelarije interne revizije, uključujući izbor njenog osoblja;
Upravljanje i vođenje svih aktivnosti interne revizije;
Izvršavanje svih drugih dužnosti koje odredi Odbor za reviziju.

- Dužnosti i odgovornosti Službenika interne revizije:**
- Izrada procedura revizije, odnosno Plana interne revizije, za sve transakcije Kompanije u skladu sa ciljevima interne kontrole, politikama i procedurama Kompanije, zasnovanim na važećem zakonodavstvu;
 - Analiza investicionog i finansijskog plana Kompanije, godišnjeg poslovnog plana i godišnjeg budžeta;
 - Analiza godišnjeg bilansa stanja, bilansa uspeha i drugih finansijskih izveštaja koji se zahtevaju zakonom;
 - Objektivna procena efikasne upotrebe resursa Kompanije i davanje adekvatnih preporuka Odboru za reviziju i Menadžmentu;
 - Provera usklađenosti i pravilnog funkcionisanja sistema i procedura kojima se obezbeđuje primena svih važećih zakona u Republici Kosovo tokom obavljanja delatnosti Kompanije, kao i dostavljanje Odboru za reviziju svih zapažanja i predloga koje smatra potrebnim;
 - Provera pravilnosti i urednosti sistema i procedura kojima se obezbeđuje da knjigovodstvena i finansijska dokumentacija Kompanije bude vođena u skladu sa računovodstvenim standardima i zakonom, te da se godišnji finansijski izveštaji pripremaju na pravilan način;
 - Sprovođenje sistematske analize poslovnih procesa i kontrola povezanih sa njima;
 - Redovno izveštavanje Odbora za reviziju;
 - Rukovođenje i upravljanje internom organizacijom kancelarije interne revizije;
 - Vođenje i nadzor svih aktivnosti interne revizije;

- Održavanje dobrih profesionalnih odnosa sa Odborom za reviziju, spoljnim revizorima, Menadžmentom i osobljem Kompanije;
- Izvršavanje svih drugih dužnosti koje odredi Odbor za reviziju;
- Za svoj rad odgovara Odboru interne revizije.

Procedura prijavljivanja:
Potrebna dokumentacija

Zainteresovani kandidati treba da dostave sledeća dokumenta:

- Zvaničnu prijavu KRV „Mitrovica“;
- Biografiju (CV);
- Motivaciono pismo;
- Kopija diplome univerziteta iz oblasti ekonomije, prava, javne administracije, javnih finansija ili drugih relevantnih oblasti za sektor koji se audituje (notarski overena kopija, dok diplomama sa stranih univerziteta mora biti nostrifikovana od strane MASHTI-ja).
- Sertifikat internog revizora u javnom sektoru**, izdat od Ministarstva finansija ili odgovarajuće relevantne domaće/međunarodne institucije u skladu sa kriterijumima MF;
- Sertifikat Ovlašćenog revizora** (obavezno);
- Sertifikat Ovlašćenog računovođe** izdat od licenciranih profesionalnih udruženja;
- Dokaz o radnom iskustvu (dokument iz trusta, ugovor o radu ili uverenje poslodavca kojim se potvrđuje menadžerska funkcija, odnosno radni zadaci i trajanje angažmana);
- Izjavu pod zakletvom, koja se može preuzeti sa veb-stranice kompanije;
- Uverenje iz kaznene evidencije, ne starije od 6 meseci, kojim se potvrđuje da kandidat nije osuđivan na kaznu zatvora dužu od šest meseci pravosnažnom sudskom odlukom;
- Kopiju lične karte izdane od Republike Kosovo.

Obrazac za prijavu i Izjava pod zakletvom mogu se preuzeti na veb-stranici Kompanije na adresi: <https://www.krv-mitrovica.com/konkurset/>.
Prijave i prateća dokumentacija dostavljaju se skenirane ili u .pdf formatu na imejl adresu: rekrutimi@krv-mitrovica.com
Rok za prijavu je **30 dana** od dana objavljivanja Javnog konkursa, počev od datuma: **12.01.2026** do datuma **11.02.2026** do 24:00 časova.

Napomena: Kandidati sa nepotpunom, neažurnom, neadekvatnom ili neblagovremeno dostavljenom dokumentacijom biće odbijeni.

KRV „Mitrovica“ A.D. Mitrovica – Suvi Do





Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnatia p.n. - 10 000Prishtinë www.kuzhina.netkuzhinaqendrore@gmail.com | tel: + 383 45709 106

Njoftim për ftesë për ofertë / Shprehje Interesi
Ndërmarrja Publike Lokale "Ku'zina" Sh.A.

Për marrje të pajisjeve me qira

Ndërmarrja Publike Lokale "Ku'zina" Sh.A. fton të gjithë të interesuarit për paraqitjen e ofertave për dhënie me qira të kompjuterve dhe printereve sipas kushteve të mëposhtme:

Kërkesat:

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia
1	Kompjuter	Copë	33
2	Monitor	Copë	33
3	UPS	Copë	33
4	Printer Color	Copë	1
5	Printer Bardh e Zi	Copë	3
6	Projektor	Copë	1
7	Perde për projektor 203x203cm	Copë	1
8	Toner	Copë	Sipas nevojës

Detajet e pajisjeve të kërkuara

Nr.1

Kompjuter:

- Procesor i3, minimum i gjeneratës së 13-të ose ekuivalent, me frekuencë 4.4 GHz dhe minimum 12 MB cache.
- RAM Memorie minimum 8 GB DDR4, me shpejtësi 3200 MHz, me mundësi zgjerimi.
- Hapësirë ruajtëse minimum 512 GB SSD me teknologji PCIe NVMe M.2.
- Kartelë grafike e integruar.
- Tastiera dhe mausi duhet te jene te përfshira.
- Sistem operativ: Windows 11 PRO ose FreeDOS.
- Kasa e tipit Tower, e përshtatshme për ambient zyrtar, me qasje të lehtë për mirëmbajtje.
- Ndërfaqe komunikimi të integruara: LAN 10/100/1000 Mbps, USB 2.0 dhe USB 3.x, si dhe hyrje/dalje audio.

Nr.2

Monitor:

- Madhësia e ekranit duhet te jete minimum 23.8” (60.5 cm)
- Rezolucioni: Full HD 1920×1080 (16:9)
- Lloji i panelit: VA, LED
- Dizajn: ZeroFrame
- Kontrasti dinamik: 100,000,000:1
- Shkëlqimi: minimum 250 cd/m²
- Koha e reagimit: 4 ms (GTG)
- Shkallëzimi i rifreskimit: 100 Hz
- Ngjyrat e shfaqura: 16.7 milion
- Këndet e shikimit: 178° horizontal / 178° vertikal
- Lidhjet: 1×HDMI 1.4, 1×VGA
- Tilt: -5° deri +20°
- Duhet te përfshihet kabllo HDMI dhe kabllo për energji

Nr. 3

UPS:

- Tipi i UPS-it: Line-Interactive me rregullim automatik të tensionit (AVR)
- Kapaciteti nominal: 1000 VA / 600 Ę
- Faktor i fuqisë së daljes: 0.6
- Tensioni i hyrjes: 170-280 VAC
- Frekuenca e hyrjes: 50 Hz / 60 Hz
- Tensioni i daljes: 230 VAC
- Frekuenca e daljes (në bateri): ±1 Hz
- Koha e transferimit nga AC në bateri: 10 ms
- Valë dalëse: Sinusoide e modifikuar
- Mbrojtja nga rritjet e tensionit

- Indikatorë: LED për gjendje funksionimi (AC, bateri, gabim)
- Lloji i baterisë së brendshme: 12 V, 9 Ah, 1 njësi
- Autonomi tipike: 100 % ngarkesë ~0.1 min; 50 % ngarkesë ~1.2 min
- Numri i prizave të daljes: 8 me mbrojtje nga overvoltage
- Priza me bateri rezervë: për pajisje kritike
- Porta komunikimi: USB me suport HID
- Monitorim: përmes USB dhe softueri për menaxhim UPS
- Mbrojtje shtesë: linja telefon/rjet (RJ-45/RJ-11), mbrojtje nga overload, discharge, overcharge
- Niveli i zhurmës: 40 dB
- Temperatura operative: 0 °C – 40 °C
- Lagështia operative: 0 % – 90 % RH pa kondensim

Nr. 4

Printer Color:

- Pajisja duhet të jetë multifunksionale: Printim, Kopjim, Skanim.
- Teknologjia e printimit: Laser / LED.
- Shpejtësia e printimit dhe kopjimit: minimumi 30 fletë/min në ngjyrë dhe B&W (A4).
- Koha e ngrohjes (Warm-up): 20 sekonda.
- Koha e printimit: 8 sekonda ngjyrë, 5 sekonda B&W.
- Rezolucioni i printimit: 1200 × 1200 dpi.
- Rezolucioni i kopjimit: minimumi 600 dpi.
- Aftësitë e skanimit: minimumi 600 dpi; mbështetje për skanim drejt Email, Folder/SMB/FTP.
- Kapaciteti standard i dokument feeder: minimum 100 fletë me auto-reversing.
- Printim duplex i integruar.
- Kapaciteti multipage për kopje: minimumi 999 kopje.
- Gjuhët e printimit të pajisjes: PCL5c, PCL6, PDF Direct, XPS ose të barabarta.
- Memoria e pajisjes: minimum 1.5 GB RAM.
- Hard disk / Storage: minimumi 250 GB.
- Kapaciteti bazë i letrës (input): minimum 1200 fletë; kapacitet maksimal: 4000 fletë me module opsionale.
- Madhësitë e letrës: A6 deri A3; gramazhi i letrës: 52–300 g/m².
- Paneli i përdoruesit: Ekran kontrolli me ngjyra / Touch LCD.
- Lidhje & interfetje: Ethernet 10/100/1000Base-T, USB, SD Card ose të barabarta.
- Protokolle rrjeti: TCP/IP, SMB, etj.
- Siguria e të dhënave: Data Overwrite Security, HDD Encryption, User Codes.
- Funksionalitete të syrit / ergonomisë: panel i lehtë për përdorim, funksione standard për kursim energjie.
- Kompatibilitet OS: Windows, Mac OS, Linux.

Nr.5

Printer Bardh e Zi:

- Pajisja duhet të jetë multifunksionale me funksione Printim, Kopjim, Skanim.
- Shpejtësia e printimit: minimum 25 fletë/minutë (B&W) për format A4.
- Rezolucioni maksimal i printimit: 1200 × 1200 dpi.
- Koha e printimit: 5 sekonda.
- Printim auto duplex i integruar.
- Rezolucioni i kopjimit: 600 × 600 dpi.
- Kapaciteti standard i letrës (input): 1200 fletë.
- Kapaciteti maksimal i letrës: 4 000 fletë me module opsionale.
- Mbështetja e madhësive të letrës: A6 deri në A3 dhe deri në 12”×18”.
- Gramatura e letrës së mbështetur: 52–300 g/m².
- Dokument feeder automatik: 100 fletë (ARDF).
- Kapaciteti i dokument feeder: 100 fletë (ARDF) ose 220 fletë (SPDF).
- Shpejtësia e skanimit: 80 imazhe/minutë (simplex); 180 imazhe/minutë (duplex) me SPDF.
- Zgjerimi i memorjes: Minimum 2 GB RAM dhe 320 GB HDD.
- Kontroli i përdoruesit: Panel operimi me ekran ngjyrë 10.1” me mundësi personalizimi.
- Gjuhët e printimit të mbështetura: PCL5e, PCL6, PDF Direct, PostScript3 emulation ose ekuivalent.
- Lidhje & rrjet: Ethernet (10/100/1000Base-T), USB host Type A, dhe opsionale Wireless LAN.
- Protokolle rrjeti: TCP/IP (IPv4, IPv6), SMB, FTP, SMTP, IMAP4 ose ekuivalent.
- Funksione sigurie: Data Overwrite Security System (DOSS), encryption HDD, authentication user, filtrim IP.
- Kapaciteti i kopjeve: 999 kopje.
- Reduktim/zhvillim dokumenti: 25 %-400 % me shkallëzime të vogla.
- Certifikime energjie: ENERGY STAR ose ekuivalent.
- Mbështetje OS: Windows, Mac OS, Linux.

- Furnizim dhe mirembajtje e tonerit.

Nr. 6

Projektor:

- Lloji i pajisjes: Projektor LCD / DLP për prezantime
- Rezolucioni: 1280 × 800 (WXGA)
- Marrja e imazhit: 16:10
- Shkëlqimi: ≥3,600 ANSI Lumens
- Kontrasti: ≥20,000:1
- Madhësia e ekranit të projeksionit: 30" – 300" diagonal
- Distanca e projeksionit: 1 – 10 m (variabel sipas lenteve)
- Lloji i lenteve: Manual Focus
- Rregullimi i këndit të imazhit: Keystone Vertical ±40°
- Burimi i dritës: Lampë me jetëgjatësi ≥4,000 orë (standard)
- Zëvendësim i lampës: i lehtë dhe i aksesueshëm
- Lidhjet e hyrjes: VGA, HDMI, Video Composite, Audio In
- Rezolucioni i hyrjes suportuar: 640×480 deri 1920×1200
- Daljet audio: Integrated speaker, minimum 2 W
- Zëri: Stereo ose mono, sipas modelit
- Funksionet: Eco Mode për kursim energjie, Auto Power Off, Freeze Image, Keystone Correction

Nr. 7

Perde për projektor:

- Perde projektori me motor elektrik
- Madhësia e sipërfaqes projekcionale: 203 × 203 cm
- Lloji i motorit: Elektrik, me komandë rrufe ose kabllo
- Materiali i sipërfaqes: Të lartë reflektueshmëri, mat, i papërshkueshëm nga drita e ambientit
- Shtresa e sipërfaqes: Anti-wrinkle / e sheshtë, e lehtë për pastrim
- Ngjyra e sipërfaqes: E bardhë ose e lehtë për reflektim maksimal
- Këndi i projeksionit: Uniforme, pa deformim të imazhit
- Lidhja e komandës: Telekomandë me kabllo ose pa tel
- Funksioni i lëvizjes: Ngjitje / zbritje e qetë, pa dridhje
- Mbajtës: Alumini ose metal i qëndrueshëm, i montueshëm në tavan ose mur
- Siguria: Mekanizëm anti-drop, mbyllje automatike në fund të lëvizjes
- Konsumi energjie: Minimal, sipas standardeve motorike
- Funksione shtesë: Limit switches për pozicionin maksimal dhe minimal, silent operation.

Qiradhënësi është i obliguar të i mirëmbaje dhe servisoj pajisjet gjatë afati të kontratës.

Dorëzimi i ofertave:

Të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertat në pliko të mbyllur, të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm mbi pronësinë dhe specifikacionet teknike, në selinë e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ku'zina" sh. a., rr. Egnatia, Lagja Ulpianë, Prishtinë.

Afati për dorëzimin e ofertave është deri më datën 19 Janar 2026, ora 16:00. Ofertat e pranuar pas kësaj date nuk do të merren parasysh.

Dokumentacioni i nevojshëm:


- Certifikatën e numrit unik të biznesit së bashku me veprimtarin primare dhe sekondare. Kopja e certifikatës TVSH-së.
- Katalogët për artikujt e ofertuar. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë broshura dhe të specifikojë modelet e produkteve që ofrojnë
- Deklarata për afatin e liferimit 5 ditë.

Afati i qirasë:

Ofertuesit të suksesshëm do t'i ofrohet kontratë qiraje për një periudhë pese (5) vjeçare.

Për informata të tjera apo për specifikimet teknike të kërkuara, mund të kontaktoni në adresën elektronike: kuzhinagendrore@gmail.com

NPL "Ku'zina" sh. a. mban të drejtën të kërkojë informata dhe dokumente shtesë nga ofertuesit që do të shprehin interesimin e tyre.



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

